



Pranuar / Dorezuar Prijemeno/Prodato Received/Delivered		05 - 06 2023		3 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKPMSHIK	4597/2023		1/7		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.656/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.656/2023 të datës 20.04.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Agjencia për Informim dhe Privatësi, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.06.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.656/2023 e datës 20.04.2023 e parashtruar nga ankuesi**
- II. **Anulohet në tërësi Konkursi i datës 09.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010963 me emrin e grupit Specialistë Ligjor për pozitën “Zyrtar Inspektimi”, konkursi i datës 09.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010962 me emrin e grupit Specialistë Ligjor për pozitën “Zyrtar i lartë për Inspektim”, konkursi i datës 08.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010956 me emrin e grupit Specialistë Ligjor për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” dhe konkursi i datës 08.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010952 me emrin e grupit Specialistë Ligjor për pozitën “Zyrtar Inspektimi” të gjithë të shpallur për pranim të hapur në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.**
- III. **Obligohet Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.**
- IV. **Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

## A r s y e t i m

Ankuesi më datë 20.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit nën shenjë Akti.nr.189/2023 të datës 29.03.2023 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, për shkak të refuzimit të aplikacionit për të vazhduar tutje në procedurën e rekrutimit sipas Konkursit të datës 09.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010963 për pozitën "Zyrtar Inspektimi", konkursi i datës 09.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010962 për pozitën "Zyrtar i lartë për Inspektim", konkursi i datës 08.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010956 për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" dhe konkursi i datës 08.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010952 për pozitën "Zyrtar Inspektimi" të gjithë të shpallur për pranim të hapur në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.05.2023 përmes e-mailit ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Informim dhe Privatësi, ndërsa Këshilli më datë 16.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia për Informim dhe Privatësi, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 3704/2023 të datës 20.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin nën shenjë Akti.nr.189/2023 të datës 29.03.2023 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Vendimi nën shenjë Akti.nr.54/2023 të datës 21.03.2023 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Vendimi nën shenjë Akti.nr.34/2023 të datës 21.03.2023 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Vendimi nën shenjë Akti.nr.154/2023 të datës 28.03.2023 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Ankesa e ankuesit e datës 28.03.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e B.B. i datës 22.03.2023; Ankesa e ankuesit e datës 21.03.2023; Ankesa e ankuesit e datës 21.03.2023; Ankesa e ankuesit e datës 27.03.2023; Vendimi nën shenjë Akti.nr.101/2023 të datës 27.03.2023 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Kërkesë për përgjigje në ankesë përmes e-mailit e datës 12.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 16.05.2023; E-mail nga A.S. për B.B. i datës 06.04.20223; Lista e aplikantëve nga Simbnj; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi i datës 22.03.2023; Aplikacioni i B.B. i datës 02.03.2023; Diplomë e shkollës së mesme "Hamdi Berisha" e B.B. me numër protokollit 3526/13 i datës 25.06.2013; Diplomë nga Universiteti "Hasan Prishtina" e B.B. me numër Nr.4977 i datës 18.10.2017; Cetifikatë nga NDI për B.B. i datës 16.05.2019; Vërtetim nga mbi punësimin e B.B. i datës 28.09.2018; Vërtetim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për B.B. me numër protokollit 2467-1 i datës 06.05.2019; Vërtetim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për B.B. me numër protokollit 6833-1 i datës 03.12.2019; Vërtetim nga mbi punësimin e B.B. i datës 06.01.2021; Vërtetim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për B.B. me numër protokollit 3984-1 i datës 31.08.2021; Vërtetim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë për B.B. me numër protokollit 6503-1 i

datës 19.08.2022; Referencë pune për B.B. me numër protokoll 5444-1 i datës 24.08.2021; Referencë pune për B.B. me numër protokoll 2447-1 i datës 06.05.2019; Letërnjoftim i B.B.; Pasqyra e llogarisë së trustit e B.B. periudha 15.05.2015 - 22.02.2023; Konkursi i datës 09.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010963 për pozitën "Zyrtar Inspektimi" në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Konkursi i datës 09.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010962 për pozitën "Zyrtar i lartë për Inspektim" në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Konkursi i datës 08.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010956 për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Konkursi i datës 08.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010952 për pozitën "Zyrtar Inspektimi" në Agjencinë për Informim dhe Privatësi;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se është e bazuar ankesa e ankuesit, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë se Agjencia për Informim dhe Privatësi, më datë 09.02.2023 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00010963 për pozitën e punës "Zyrtar i Inspektimi", me afat të aplikimit 02.03.2023 deri 16.03.2023, me datë 09.02.2023 Konkursin me numër reference RN00010962 për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Inspektim", me afat të aplikimit 02.03.2023 deri 16.03.2023, me datë 08.02.2023 Konkursin me numër reference RN00010956 për pozitën e punës "Zyrtar Ligjor 2", me afat të aplikimit 01.03.2023 deri 08.03.2023, me datë 08.02.2023 Konkursin me numër reference RN00010952 për pozitën e punës "Zyrtar Inspektimi", me afat të aplikimit 01.03.2023 deri 08.03.2023 në të gjitha këto konkurse ka aplikuar dhe ankuesi. Ndërsa Menaxherja e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi ka nxjerr vendimin nën shenjë Akti.nr.54/2023 të datës 21.03.2023, vendimin nën shenjë Akti.nr.34/2023 të datës 21.03.2023, vendimin nën shenjë Akti.nr.154/2023 të datës 28.03.2023 dhe vendimin nën shenjë Akti.nr.101/2023 të datës 27.03.2023, në të gjitha këto vendime ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti nuk ka bashkangjitur dëshminë "të mos jetë i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje" si rrjedhojë i njëjti nuk është kualifikuar që të vazhdojë tutje. Ankuesi kundër vendimit nën shenjë Akti.nr.54/2023 të datës 21.03.2023, vendimit nën shenjë Akti.nr.34/2023 të datës 21.03.2023, vendimit nën shenjë Akti.nr.154/2023 të datës 28.03.2023 dhe vendimit nën shenjë Akti.nr.101/2023 të datës 27.03.2023 ka parashtruar ankesë brenda afatit të paraparë ligjorë. Më tej në fazën e verifikimit paraprak Menaxherja e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi me vendimin me numër Akti.nr.189/2023 të datës 29.03.2023 ka vendosur lidhur me mos përfshirjen e ankuesit në listën e ngushtë, me arsyetim se ankuesi nuk ka bashkangjitur dëshminë "të mos jetë i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje" rrjedhimisht ankuesi nuk është kualifikuar që të vazhdojë procedurën e rekrutimit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin nën shenjë Akti.nr.189/2023 të datës 29.03.2023 të Menaxheres se Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, më datë 20.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3704/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimor se pika 2, nën pika 2.5 "të mos jetë i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje"

ka ngjallur konfuzion dhe se institucioni në fjalë Agjencia për Informim dhe Privatësi është dashur ti pranoj ankesat e tij të brendshme dhe të vazhdojë tutje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar fillimisht se ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill i njëjti ka pranuar se nuk ka bashkangjitur dokumentin "të mos jetë i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje" me rastin e aplikimit, po ashtu edhe në bazë të përgjigjes në ankesë nga ana e institucionit konstatohet se i njëjti nuk ka bashkangjitur dokumentin e kërkuar sipas konkurseve të lartë cekura.

Referuar Konkursit të datës 09.02.2023 me emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër reference RN00010963 kushtet për pozitën "Zyrtar Inspektimi" janë përcaktuar: kërkesa të përgjithshme për pranim janë kërkuar; *Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për Gjuhët; Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; Të mos jetë i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale me dashje; Të mos ketë në fuqi një mase disiplinore për largimin nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji; Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite të studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare, gazetari, shkenca shoqërore. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale.***

Referuar Konkursit të datës 09.02.2023 me emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër reference RN00010962 kushtet për pozitën "Zyrtar i Lartë për Inspektim" janë përcaktuar: kërkesa të përgjithshme për pranim janë kërkuar; *Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për Gjuhët; Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; Të mos jetë i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale me dashje; Të mos ketë në fuqi një mase disiplinore për largimin nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji; Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite të studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare, gazetari, shkenca shoqërore. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale.***

Referuar Konkursit të datës 08.02.2023 me emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër reference RN00010956 kushtet për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" janë përcaktuar: kërkesa të përgjithshme për pranim janë kërkuar; *Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për Gjuhët; Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; Të mos jetë i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale me dashje; Të mos ketë në fuqi një mase disiplinore për largimin nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji; Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite të studimeve në fushën e drejtësisë, marrëdhënie ndërkombëtare, Integritet Evropian si dhe shkenca shoqërore. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale.***

Referuar Konkursit të datës 08.02.2023 me emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër reference RN00010952 kushtet për pozitën "Zyrtar Inspektimi" janë përcaktuar: kërkesa të përgjithshme për pranim janë kërkuar; *Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për Gjuhët; Të jetë i aftë*

*në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; Të mos jetë i dënuar me vendimin e formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale me dashje; Të mos ketë në fuqi një mase disiplinore për largimin nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji: Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare dhe shkenca shoqërore. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkurseve të lartcekura dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit deri në fazën kur ankuesi ka parashtruar ankesë, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht tek shtojca Nr.2, Kodi i grupit 1. Gr. të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht për emrin e grupit Specialistë Ligjor, fusha e kërkuar e arsimit është ajo "Juridik", ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 09.02.2023 me emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër reference RN00010963 kushtet për pozitën "Zyrtar Inspektimi" ka përfshirë edhe fusha tjera të arsimit siç janë; *Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare, gazetari, shkenca shoqërore*, ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 09.02.2023 me emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër reference RN00010962 kushtet për pozitën "Zyrtar i Lartë për Inspektim" ka përfshirë edhe fusha tjera të arsimit siç janë; *Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare, gazetari, shkenca shoqërore*, ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 08.02.2023 me emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër reference RN00010956 kushtet për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" ka përfshirë edhe fusha tjera të arsimit siç janë; *Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, marrëdhënie ndërkombëtare, Integritet Evropiane si dhe shkenca shoqërore* dhe tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 08.02.2023 me emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër reference RN00010952 kushtet për pozitën "Zyrtar Inspektimi" ka përfshirë edhe fusha tjera të arsimit siç janë; *Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare dhe shkenca shoqërore*.

Andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me rastin e përfshirjes së fushës së arsimit në konkursin me numër reference RN00010963 të datës 09.02.2023 kushtet për pozitën "Zyrtar Inspektimi" **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare, gazetari, shkenca shoqërore*, në konkursin me numër reference RN00010962 të datës 09.02.2023 kushtet për pozitën "Zyrtar i Lartë për Inspektim" **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare, gazetari, shkenca shoqërore*, në konkursin me numër reference RN00010956 të datës 08.02.2023 kushtet për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë me së paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, marrëdhënie ndërkombëtare, Integritet Evropiane si dhe shkenca shoqërore*, si dhe në konkursin me numër reference RN00010952 të datës 08.02.2023 kushtet për pozitën "Zyrtar Inspektimi" **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë me së*

*paku tre (3) vite te studimeve në fushën e drejtësisë, administratë publike, marrëdhënie ndërkombëtare dhe shkenca shoqërore, si kriter i konkurseve për emrin e grupit Specialist Ligjor”, Agjencia për Informim dhe Privatësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 6 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive” si dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenin 4 paragrafin 2 ku përcaktohet se: “Parimet e pranimit dhe avancimit në karrierë: Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore”.*

Andaj Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 09.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010963 me emrin e grupit Specialistë të Ligjor për pozitën “Zyrtar Inspektimi”, konkursi i shpallur me datën 09.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010962 me emrin e grupit Specialistë të Ligjor për pozitën “Zyrtar i Lart për Inspektim”, konkursi i shpallur me datën 08.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010956 me emrin e grupit Specialistë të Ligjor për pozitën “Zyrtar Ligjor 2” dhe konkursi i shpallur me datën 08.02.2023 sipas numrit të referencës RN00010952 me emrin e grupit Specialistë të Ligjor për pozitën “Zyrtar Inspektimi” të gjithë të shpallur nga Agjencia për Informim dhe Privatësi është bërë në kundërshtimin me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë ka vendosur të anulojë konkurset e lartë cekura si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga këto procedura të rekrutimit.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton së një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë

(30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda.A.nr.656/2023.**

**Rushit KAJTAZI**

**Procesmbajtës**

**Eshref SHABANI**

**Kryetar i Kolegjit**



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi ;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.